

# KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN KASKO TË MJETEVE MOTORIKE –Qershor 2020

## Përmbajtja

- Neni 1** Përkufizimet e përgjithshme  
**Neni 2** Objekti i sigurimit dhe rreziqet e siguruar  
**Neni 3** Rasti i siguruar  
**Neni 4** Shtirja territoriale  
**Neni 5** Periudha sigurimit  
**Neni 6** Shuma e sigurimit, sigurimi i dyfishtë, mbi dhe nën sigurimi  
**Neni 7** Rregullimi i primeve sipas sistemit Bonus - Malus  
**Neni 8** Primi i sigurimit  
**Neni 9** Përjashtimet e përgjithshme  
**Neni 10** Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodh dhe në rast se ndodh dëmi  
**Neni 11** Pjesëmarrja e të siguruarit në dëm-franshiza  
**Neni 12** Dëmshpërblimi lartësia e demit  
**Neni 13** Afati për kompensimin e dëmit (pagesën e dëmshpërblimit)  
**Neni 14** Regresi  
**Neni 15** Ekspertiza  
**Neni 16** Situata ligjore pas dëmit  
**Neni 17** E drejta për ankesë  
**Neni 18** Shkëputja e kontratës së sigurimit dhe kthimi i premisë së sigurimit  
**Neni 19** Forma e shkruar  
**Neni 20** Marrëveshja për gjyqin përgjegjës  
**Neni 21** Sigurimi Kasko për automjetet e dhëna me qira (LEASING)  
**Neni 22** Ndryshimi i kushteve të sigurimit apo i tarifës së primit

### Neni 1

#### Përkufizimet e përgjithshme

- 1. Sigurusi** – Nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
- 2. I Siguruari** – Është person fizik ose juridik, pronar i gjërave të siguruar ose person që ligjërisht i është lejuar të jetë përfitues. Nga momenti i nënshkrimit të kontratës-polices së sigurimit ky person është mbajtësi i polices së sigurimit.
- 3. Kontraktues i sigurimeve** – Personi fizik ose juridik, i cili në emër dhe në interes të të siguruarit ngarkohet me lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit.
- 4. Polica e sigurimit** – Është kontratë e lidhur në mes të Siguruesit dhe të Siguararit për marrëveshjen e arritur për sigurim.
- 5. Premia** – Është shuma e cila paguhet në bazë të kontratës së sigurimit.
- 6. Përfituesi** – Person fizik ose juridik në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit apo që përfiton nga kjo e fundit.
- 7. Perdoruesit-shfrytëzuesi** – Kupton personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve shënohen detyrimisht në formën propozues dhe /ose edhe në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi, ose të kenë autorizim përkatës valid.
- 8. Mjeti motorik** – Është një mjet në lëvizje me anë të energjisë së vetë. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysmërimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.
- 9. Franshiza** – Pjesa e zbritshme, gjegjësisht pjesëmarrja në dëm nga i Siguruari, e cila mundet të jetë në % dhe € pjesë te zbritshme (Vetëmbajtje).

### Neni 2.

#### Objekti i sigurimit dhe rreziqet e siguruar

1. Siguruesi, ofron mbulim për të gjithë mjetet motorike, të klasifikuar si të tilla në aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me humbjet apo dëmtimin e

plotë ose të pjesshëm të tyre, si rezultat i rreziqeve të parashkuara në këto kushte të sigurimit, në përputhje me, përcaktimet e bëra në policën e sigurimit kundrejt pagimit të primit të sigurimit sipas rreziqeve të siguruar nga i Siguruari. Siguruesi nuk mbulon në sigurim dhe nuk përgjigjet për fitimin e humbur.

2. Me sigurimin Kasko rreziqet e mëposhtme janë të siguruar vetëm nëse ato janë të shënuar edhe në policën e sigurimit:
  - 2.1 **Dëmtimi aksidental**, do të konsiderohet një ngjarje e jashtme e papritur, e cila shkaktohet drejtpërdrejt në mjetin motorik të siguruar si rezultat i forcave mekanike, duke mbuluar dëmin edhe kur ju jeni vetë fajtorë për aksidentin, me përjashtim dëmet e ndodhura gjatë drejtimit të automjetit pa patent-shofer, paafësi për drejtimin e mjetit motorik kur jeni nën ndikimin e narkotikëve, alkoolit, terapive të ndryshme, të cilat udhëzojnë te mos vozitni gjatë përdorimit të tyre.
  - 2.2 **Zjarri, Eksplozioni, Rrufeja, Rënia e fluturakeve ajrore dhe pjesëve të tyre:** Zjarri është flaka e shkaktuar jashtë vatrës së vet, e cila bën dëm dhe përhapet me forcën e vet në mjetin motorik të siguruar gjatë parkimit ose kur automjeti është në lëvizje. Zjarri do të konsiderohet një formë e djegies me flakë e të mirave materiale. **Eksplozioni** është një dukuri e çastit e forcës, e cila vjen si pasojë e bymimit të gazrave apo avujve. **Rrufeja** është shkarkimi atmosferik i energjisë elektrike. Ndikimi direkt i forcës apo nxehtësisë së një rrufeje, në automjetin e siguruar (goditja e drejtpërdrejtë e rrufesë në automjetin e siguruar). Siguruesi do të paguaj të gjitha dëmet si pasojë e rënies së drejtpërdrejtë të një fluturake ajrore apo pjesëve të saj në mjetin motorik të siguruar.
  - 2.3 **Katastrofat natyrore:** Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj të shkaktuar nga: Stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi, kur katastrofa natyrore është e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga autoritetet përkatëse shtetërore. Ndikimi i drejtpërdrejtë i rrufeve, rrëqetë, rrënojat, rrëshqitjet e dheut, rrymat e meteorëve, ortekët, ortekët e çatisë (si dhe rëniet e akullit nga ndërtesat), presioni i borës, breshëritë, përmbytjet
    - **Stuhi** konsiderohet lëvizja e ajrit me shpejtësi 17.2m/s ose 62 km/h, do të konsiderohet se ka fryrë era me këtë shpejtësi në një vend ku gjenden gjërat e siguruar, në qoftë se era i ka thyer degët dhe trungjet ose i ka dëmtuar objektet ndërtimore të mirëmbajtura rregullisht. Në rast dyshimi, i Siguruari duhet ta vërtetojë shpejtësinë e erës me raportin e shërbimit hidrometeorologjik. Përfshin dëmin e shkaktuar nga objektet që hedhen në kundrejt automjetit nga këto forca të natyrës.
    - **Breshëri** është reshje atmosferike që formohet me lëvizjen e shpejtë vertikale të ajrit dhe ftohja e shpejtë të tij. Këto reshje formohen nga pikat e shiut të ngrira si akull.
    - **Shtypja (presioni) i borës** është ndikimi i forcës nga masat e borës apo masat e akullit, të cilat janë mbledhur në mënyrë të natyrshme dhe janë në gjendje të qetë (nuk janë në lëvizje e sipër).
    - **Shembja e shkëmbit/Goditja e gurit** është shkëputja dhe rënia e natyrshme e masave të gurta në terren.
    - **Përmbytja** konsiderohet dalja e ujit nga kufijtë normal të rrjedhjeve natyrore apo artificiale të liqeneve, rezervarëve duke kaluar bregun. Siguruesi do të jetë përgjegjës për dëmet në mjetin motorik të shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujërave edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore, duke përjashtuar dëmet nga derdhja e ujit prej rubinetëve të hapura, pëlcitja apo çarja e gypave të vjetër nga korrozioni, nga bllokimi i kanalizimit nga çfarëdo hedhurine tërmeti dhe rrëshqitja e tokës si dhe dëmet gjatë kalimit të lumenjve ose pellgjeve.
    - **Vërshimi** konsiderohet edhe përmbytja e papritur e terrenit për shkak të formimit të shpejtë të sasisë së madhe të masës së ujit që krijohet si pasojë e shtrëngatës.
  - 2.4 **Dëmtimi i automjetit në vend-parkim**, mbulohet kur dëmi ka ndodhur gjatë kohës që automjeti është i parkuar në vende të parapara nga organet kompetente, dëmi i shkaktuar nga një mjet tjetër motorik të pidentifikuar, duke përjashtuar dëmet që janë të lidhura ngushtë me

ngjarje të luftës, demonstrata dhe rebelimi civil, vetëm nëse është kontraktuar ndryshe.

- 2.5 Përplasja e automjetit** në lëvizje me kafshët e të gjitha llojeve në rrugët me trafik publik
- 2.6 Vjedhja, tentim vjedhja:** konsiderohet përvetësimi në mënyrë të paligjshme i automjetit të siguruar apo pjesëve të tij, nga persona të pa njohur nga i Siguruari. Rasti duhet të vërtetohet apo dokumentohet nga organet kompetente si policia, prokuroria, gjykata etj. Tentim vjedhja, konsiderohet çdo tentativë për ta vjedhur mjetin motorik të siguruar ose pjesët e tij, por që qëllimi nuk është arritur përveç që ka shkaktuar dëme të tjera ndaj mjetit motorik të siguruar.
- 2.7 Thyerja e xhamave** përfshinë thyerjen e xhamave që nga plasaritja e deri te dëmtimi total i tij dhe atë të xhamave të përparme, të pasme, anësor, të tavaneve të hapura përfshirë edhe xhamat e dritave (ato që janë të vendosura pas prodhimit, duhet të jenë të vendosura nga servisi adekuat) shkaktuar nga goditja e një objekti në lëvizje, por përjashtohen dhe nuk kompensohen dëmet e shkaktuara në xhama tjerë që nuk janë përfshirë në katalogun e prodhimit por që është vendosur në mjetin motorik pas prodhimit.
- 2.8 Grabitja dhe tentativa për grabitje** konsiderohet çdo veprim për përvetësimin me force të mjetit motorik të siguruar, veprim i cili kryhet nga një e më shumë persona të panjohur për të siguruarin, rast i cili duhet të vërtetohet apo dokumentohet nga organet kompetente si policia, prokuroria, gjykata.
- 2.9 Demonstrata (manifestimet), Grevat, Turbullirat civile** do te kuptohet, shkatërrimi ose dëmtimi i shkaktuar nga:
1. Çdo veprim të kryer gjatë demonstratave (manifestimeve) ose turbullirave civile nga çdo person që merr pjesë së bashku me të tjerët në këto demonstrata (manifestime) ose turbullira civile;
  2. Çdo veprim keqdashës i bërë nga çdo grevist ose punonjës i pezulluar nga puna në përkrahje të grevës ose rezistencës ndaj pezullimit nga puna , ose i bërë gjatë çrregullimit në punë nga çdo person që merr pjesë në to qoftë kur ky veprim është kryer ose jo gjatë demonstratave (manifestimeve), ose turbullirave civile ose
  3. Çdo veprim i çdo autoriteti publik që ka për qëllim shtypjen ose minimizimin e pasojave të çdo demonstratave (manifestimi) ose turbullirave civile publike ekzistuese ose ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e pasojave të çdo veprimi të tillë si ato të referuara në pikën 2. Por në rast të humbjes ose dëmit të shkaktuar nga çdo gjë prej këtyre veprimeve si ato të përshkruara në pikën 2 të mësipërme nuk do të përfshihet (nëse veprimet e tilla nuk janë kryer gjatë demonstratave (manifestimeve) ose turbullirave civile) çdo humbje ose dëmtim nga zjarri sidoqoftë nga shkaku i këtij zjarri ose çdo humbje apo dëmtim i shkaktuar gjatë vjedhjes ose tentim vjedhjes.
- 2.10 Vandalizmi dhe/apo aktet keqdashëse – nënkuptohen verpimet keqdashëse apo të qëllimshme mbi mjetin motorik. Me këto akte kuptohet** humbja, shkatërrimi ose dëmtimi, shkaktuar nga zjarri, eksplozioni apo goditja me ndonjë mjet tjetër mbi mjetin e siguruar, shkaktuar direkt ose indirekt nga dëmtimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash.

### Neni 3

#### Rasti i Siguruar

Ngjarja e ardhshme e shkaktuar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale e pavarur nga dëshira e Kontraktuesit apo te siguruarit, e cila ka për pasojë ndodhjen e dëmit, për rastin e siguruar për rreziqet e mbuluara nga kontrata e sigurimit. Siguruesi do të dëmshpërblej te i Siguruari deri në shumën e siguruar, për humbjet ose dëmtimet e plota ose të pjesëshme në mjetin motorik të siguruar, të shkaktuar nga rreziqet për të cilat është i siguruar.

### Neni 4

#### Shtirja Territoriale

1. Sigurimi mbulon territorin e Republikës së Kosovës në kuptimin gjeografik.
2. Siguruesi ofron zgjerimin e mbulimit jashtë territorit të Kosovës, kundrejt marrëveshjes së veçantë dhe shënimeve të veçanta në policen e Sigurimit.

### Neni 5

#### Periudha sigurimit

Periudha e sigurimit është periudha kohore e një viti, përveç nëse kontrata e sigurimit është lidhur për kohë më të shkurtër se sa një vit. Secilën herë në datën

e ripërtëritjes, përfundon periudha e mëparshme dhe fillon periudha e ardhshme e sigurimit. Data e ripërtëritjes është e shënuar në policë (si datë e fillimit).

### Neni 6

#### Shuma e sigurimit, mbi sigurimi dhe nën sigurimi

- 1. Shuma e siguruar** – Mjeti motorik, i shënuar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim, për një shumë të siguruar, e cila përcaktohet në marrëveshje midis siguruesit dhe te siguruarit. Shuma e siguruar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë ose me vlerën e tregut. Në rast se, të dy palët bien dakord, që shuma e siguruar të jetë më e vogël se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi nën sigurim dhe do të zbatohen procedurat e nën sigurimit në pikën 3 të këtij neni.
- 2. Mbi sigurimi** – Nëse, shuma e siguruar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorik të ri, siguruesi dhe i siguruari, kanë të drejtë të bëjnë ndryshimet përkatëse në policën e sigurimit, duke e zvogëluar si shumën e siguruar ashtu edhe primin e sigurimit. Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së siguruesit, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip të mjetit motorik te ri, duke e zbritur pjesën e zditshme. Nëse, i siguruari, lidh kontratën e sigurimit me qellim që të arrijë përfitime nga mbi sigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.
- 3. Nën sigurimi** – Siguruesi dhe i siguruari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorik për një shumë sigurimi më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri. Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitoj i siguruari, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nën sigurimit. Koeficienti i nën sigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorik të ri.

### Neni 7

#### Rregullimi i primeve sipas sistemit Bonus - Malus

Sistemi Bonus-Malus është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit. Rregullimi (rritja ose zvogëlimi) i primit sipas sistemit Bonus-Malus lejohet dhe primi zvogëlohet kur gjatë vitit paraprak të sigurimit, i siguruari nuk ka paraqitur dëm, përmes të cilit Kompania e Sigurimeve "Elsig" e ka kryer pagesën apo ka vërtetuar obligimin për pagesë. E drejta për një shkallë të caktuar të premisë (bonus/malus) lidhet me pronarin (personin), përkatësisht përdoruesin e automjetit dhe nuk kalon te pronari i ri.

Bonusi llogaritet tek vazhdimi apo ripërtëritja e sigurimit:

Shkalla e bonusit te TPL-ja		Shkalla e bonusit Kasko
10	100%	0%
9	90%	10%
8	85%	15%
7	80%	20%
6	75%	25%
5	70%	30%
4	65%	35%
3	60%	40%
2	55%	45%
1	50%	50%

I siguruari i cili për herë të parë ka bërë sigurimin me kohëzgjatje më të shkurtër se një vit, nuk ka të drejtë në bonusin në vitin e ardhshëm të sigurimit, pa marrë parasysh a ka pasur ndonjë dëm.

Kur i siguruari në periudhën e mëparshme të sigurimit ka pasur një dëm, humb të drejtën për bonus për çdo dëm të paraqitur në periudhën e vëzhgimit pavarësisht nga kohëzgjatja e sigurimit, i siguruari zhvendoset për vitin e ardhshëm të sigurimit për dy (2) shkallë premie më lart,

#### **Dëmet të cilat nuk ndikojnë në bonus**

Dëmi i cili është paraqitur në kasko të plotë nuk ndikon në bonus nëse ka të bëjë me rreziqet si në vijim:

- Breshëri
- Goditja e rrufës
- Orteku i borës

- Rënia e fluturakes
- Shkaktimi me qëllim i dëmit në objektet e siguruar me qëllim të parandalimit të dëmit më të madh në atë objekt apo objekt tjetër të personave.

#### **Rezultatet teknike të sistemit bonus - malus**

##### **1. Bonusi**

- Për të siguruarin me 5 apo më shumë automjete premia caktohet varësisht nga pjesëtimi (raporti) i dëmit të paguar dhe premisë funksionale të paguar në tri vitet paraprake të sigurimit (rezultati teknik);
- Për të siguruarin tek i cili raporti i dëmeve të paguara dhe premisë funksionale të paguar në tri vitet paraprake të sigurimit ka arritur vlerën më pak se sa 80%, llogaritet zbritja (Bonusi) në preminë e sigurimit për periudhën e ardhshme të sigurimit është e barabartë me çerekun e ndryshimit në mes 80% dhe përqindjes së raportit të realizuar;
- Për të siguruarin, i cili në tri vitet paraprake të sigurimit gjatë kohëzgjatjes së sigurimit nuk ka pasur dëme të paguara pranohet zbritja bonusit në preminë e sigurimit për vitin e ardhshëm të sigurimit në lartësi deri 50%.

##### **2. Malusi**

Malusi të siguruarin tek i cili përpjesëtimi (raporti) i dëmeve të paguara dhe premisë funksionale të paguar për tri vitet paraprake të sigurimit ka arritur vlerën më shumë se 110%, llogaritet pagesë shtese (malus) në primin e sigurimit për vitin e ardhshëm të sigurimit në përqindjen e cila është e barabartë me çerekun e ndryshimit në mes të raportit të realizuar dhe 110%, në mënyrë që ajo pagesë shtesë (malus) mund të arrijë vlerën më së shumti 50%.

Nëse nuk ka rritje të primit për një ose më shumë vite sigurimi, kjo mund të merret parasysh në rregullimet e primeve në vitet në vijim.

Rritja e primeve nuk mund të bëhet deri në një vit nga fillimi i sigurimit dhe më pas në intervale prej më pak se një viti.

Nëse Kompania e Sigurimeve "Elsig" nuk ka në dispozicion të dhëna mbi premitë dhe dëmet për më së paku tri vitet e kaluara të sigurimit, atëherë për vërtetimin e rezultatit teknik shfrytëzohen të dhënat për dy respektivisht një vit të sigurimit. Sipas rezultateve teknike primi kalkulohet në këtë mënyrë:

Rezultati teknik sipas këtyre kushteve llogaritet edhe për automjetet, të cilat i siguruari i siguron në vitin vijues të sigurimit.

Në rast të ndërprerjes së sigurimit dhe lidhjes së sërishme të kontratës për sigurimin, premia llogaritet në bazë të raportit të dëmit të paguar dhe premisë funksionale të paguar për tri vitet e fundit të sigurimit gjatë kohëzgjatjes së sigurimit para ndërprerjes së sigurimit.

Nëse ndërprerja ka zgjatur më shumë se dy vjet, premia llogaritet e plotë pa zbritje (bonus) dhe pagesë shtesë (malus).

#### **Neni 8**

##### **Primi i sigurimit**

Primi duhet të paguhet me rastin e lëshimit apo nënshkrimit të sigurimit, duke përfshirë taksat. Primi paguhet nga mbajtësi i policës në shkëmbim të policës së sigurimit. Primi duhet të paguhet brenda afateve të përcaktuara në kontratë të sigurimit. I siguruari paguan komplet primin nëse nuk është kontraktuar ndryshe. Pagesa e premisë kryhet me transferim bankar d.m.th. pagesa duhet të jetë e dëshmuar me pagesë përmes bankës. Në të kundërtën polica e sigurimit nuk është vlefshme, vetëm në rast se është kontraktuar ndryshe.

1. Nëse sigurimi është kontraktuar në atë mënyrë që primi të paguhet me këste, i siguruari paguan këstin e parë në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit;
2. Në rast të dëmit total, të gjitha këstet e mbetura të papaguara të primit duhet të paguhet para se të bëhet kompensimi i dëmit apo zbriten nga shuma e pagesës së dëmit;
3. Kur i siguruari nuk paguan këstet në vazhdim sipas afateve kohore të caktuara me kontratë apo marrëveshje, sigurimi pezullohet nga ora 24.00, të ditës së 15 pas përfundimit të afatit për pagesën e këstit në vijim. Siguruesi ka të drejtë të kërkoj ndërprerjen e Polices së sigurimit;
4. Mbulesa siguruese hynë në fuqi në datën dhe orën e përcaktuar në policen e sigurimit si ditë dhe orë e fillimit, (nëse nuk ceket ora në policën e sigurimit ai sigurim hynë në fuqi në orën 24:00 të datës së fillimit të sigurimit) nëse atë ditë është paguar primi i sigurimit ose kësti i parë i primit ashtu siç është paraparë me kontratë.

#### **Neni 9**

##### **Përgjithshme**

Sigurimi nuk mbulon ngjarjet e dëmtimit (vetëm nëse nuk është kontraktuar ndryshe):

1. Të cilat ndodhin gjatë përgatitjes ose kryerjes së një veprë penale nga ana e mbajtësit të policës për të cilën qëllimi është element i veprës penale;
2. Të cilat dalin nga pjesëmarrja në garat sportive motorike (gjithashtu duke shënuar mitingje) dhe udhëtimet përkatëse të trajnimit;
3. Të cilat janë shkaktuar nga trazirat civile, ngjarjet e luftës, prirjet të mëdha dhe tërmetet;
4. Nga ndikimi i rrezatimit jonizues, nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive etj.;
5. Të shkaktuara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga akte terroriste, që rezultojnë nga apo kanë lidhje me çfarëdo akti terrorizmi. Termi "akti terrorizmi" duhet kuptuar si një përdorim i forcës së kryer nga ose për qëllime politike, fetare, ideologjike ose etnike ose për arsye të tilla nga (a) grupet e personave që veprojnë në emër të tyre, në emër të ose në lidhje me b) Organizata ose qeveritë kanë për qëllim të ndikojnë në një qeveri dhe / ose të frikësojnë publikun ose ndonjë pjesë të publikut. Përveç kësaj, përjashtohen rastet e humbjeve që janë shkaktuar direkt ose indirekt, që rrjedhin nga ose lidhen me veprimet e ndërmarra për të mbajtur, parandaluar ose shtypur aktet e terrorizmit;
6. Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruari, anëtarët e familjes përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikëqyrjes të vendit të punës ose parkimit, larja, parkimi;
7. Dëmet nga vjedhja ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij;
8. Dëmet nga vjedhja e pjesëshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme;
9. Dëmet nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës;
10. Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit të lumenjve ose pellgjeve;
11. Dëmet e shkaktuara nga neglizhencia në mirëmbajtjen e automjetit të siguruar, për shkak përdorimit të gabuar të materialit, harxhimi i materialeve të frenimit nga përdorimi jo adekuat, harxhimi i gomave mbi kufirin e lejuar, prerja, shpurja dhe dëmtimi i gomave në rrugë si dhe shkëputja e tyre nga mjeti motorik etj. Neglizhencë konsiderohet edhe mospërshatja e shpejtësisë me kushtet atmosferike (Neglizhencë konsiderohet edhe tejkalimi i shpejtësisë mbi shpejtësinë e lejuar. Neglizhencë e rëndë konsiderohet tejkalimi i shpejtësisë mbi 50 km/h më e madhe se sa është e lejuar);
12. Përjashtohen dëmet që ndodhin nga mosndërrimi i gomave sipas stinës, gjë e cila është e rregulluar me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, ku sipas nenit 227, Sezoni dimëror, pika 1, ku thuhet se nga data 15 Nëntor deri më 15 Mars, automjetet që marrin pjesë në trafikun rrugor duhet t'i kenë pajisjet dimërore (dëmet që ndodhin si pasojë e rrëshqitjeve etj.);
13. Dëmet e shkaktuara nga mbipesha, dëmet e shkaktuara gjatë ngarkimit të barrës, në automjetet lejohen të barten-transportojnë vetëm ai numër i personave sa ka ulëse të montuara në automjetet, përkatësisht sa janë shënuar në lejen e komunikacionit çështje kjo e rregulluar me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor të Republikës së Kosovës e nëse në rast të aksidentit apo dëmit ka më shumë se kaq pasagjerë Kompania e Sigurimeve "Elsig" do të kompenson vetëm 70% të dëmit;
14. Dëmet nga përmytja ose shkatërrimi i automjetit gjatë punës në kasta ose gjatë punës në moçale në terrenin me lym ose të shtruar me rërë ose të ngjashëm po qe se ndryshe nuk është kontraktuar;
15. Shpenzimet e tërheqjes ose transportit të automjetit të dëmtuar nëse ndryshe nuk është kontraktuar;
16. Dëmet indirekte, të cilat shkatohen nga realizimi i rastit të siguruar, si: Humbja e fitimit, koha e humbur, dënimet, shpenzimet e marrjes me qira të automjetit, shpenzimet për eliminimin e shkaqeve të dëmtimit, shpenzimet për tërheqjen e automjetit, i cili ka rrëshqitur nga rruga, shpenzimet për pastrimin e vendit ku ka ndodhur fatkeqësia, shpenzimet e transportit të ngarkesës, të cilën automjeti ka qenë duke e transportuar;
17. Dëmet e shkaktuara nga përvetësimi, mashtrimi ose fshehja nga ana e personit, të cilit automjeti i është dhënë me qira ose në shfrytëzim, nëse ndryshe nuk është kontraktuar, dëmet e shkaktuara gjatë kohës kur automjeti i huazuar i jepet nën qiradhënie një personi të tretë;
18. Dëmet e shkaktuara nga përdoruesi pa patentë shofer;

19. Dëmet e shkaktuara në automjet kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e alkoolit e testi tregon se në organizmin e tij ka alkool më shumë se 0,5 promilë apo 5 gr/l, drogës ose narkotikëve të tjerë, të gjitha këto vërtetohen me testet përkatëse, ose pas ndodhjes së rastit të siguruar refuzon t'i nënshtrohet testeve të tilla;
20. Dëmet ose humbjet e gjëseneve, objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjetin e siguruar në momentin e rastit të siguruar;
21. Dëmet e shkaktuara gjatë marrjes apo bllokimit të automjetit me vendim gjyqësor ose nga organet e administratës shtetërore në vend dhe jashtë vendit;
22. Dëmet e shkaktuara nga përdorues, emrat e të cilëve nuk janë të shënuar në kontratë-policë të sigurimit;
23. Shpenzimet e blerjes së çelësave të rinj, ndërrimit apo riparimit;
24. Dëmet, të cilat nuk janë kontraktuar në policë, ndryshimet, përmirësimet, riparimet, zvogëlimi i vlerës, pamja ose performanca e jashtme, humbja e përdorimit ose kostot e një makine zëvendësuese nuk do t'i mbulojë siguresi;
25. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni kur aksidenti nuk është i njoftuar në polici apo në repartin zjarrfikësve;
26. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme të mjetit motorik;
27. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo ekspulSIONI (eksplozioni) ku shkak ka qenë pirja e duhanit në mjetin motorik.

#### Neni 10

##### Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodh dhe në rast se ndodh dëmi

#### 1. Detyrimet para paraqitjes së ngjarjes së siguruar

- 1.1 Automjeti i siguruar mund të përdoret vetëm për qëllimet e dakorduara. Nëse automjeti i siguruar përdoret nga policë-mbajtësi ose me lejen e tij e përdor me qëllim tjetër, siguresi është i liruar nga pagesa përderisa primi i rënë dakord nuk i përket premisë që do të duhej, të paguhej sipas tarifës për rrezikun më të lartë që lidhet me përdorimin, i cili nuk është kontraktuar;
- 1.2 Automjeti i siguruar mund të përdoret nga policë-mbajtësi ose me lejen e tij pa autorizim të vlefshëm të automjetit motorik ose nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, që dëmton aftësinë për të drejtuar automjetin ose me defekte teknike të dukshme, serioze, të cilat dëmtojnë sigurinë e trafikut, si dhe gomat që nuk janë të përshtatshme ligjërisht;
- 1.3 Për më tepër, automjeti i siguruar mund të përdoret vetëm për të transportuar sipas destinimit në përputhje me rregulloret përkatëse të automjeteve motorike ose automjeti i siguruar nuk mund të ketë më shumë ngarkesë sesa lejohet;
- 1.4 Nëse një ngjarje e siguruar rezulton nga një shkelje e këtyre detyrimeve ose dëmi rritet si rezultat, siguresi lirohet nga detyrimi i tij për të siguruar përfitime, përderisa shkelja e detyrimeve lidhet me shkakun e ngjarjes së siguruar.

#### 2. Detyrimet pas ndodhjes së ngjarjes së siguruar, mbajtësi i policës detyrohet

- 2.1 Të njoftojë siguresin brenda 72 orëve nga momenti i ndodhjes së aksidentit-dëmit dhe atë në pikën më të afërt të K.S. "Elsig", duke i dhënë faktet sa më saktë që të jetë e mundur;
- 2.2 Menjëherë t'i ndërmarr të gjitha masat e mundshme për të shmang dhe minimizuar humbjet ose dëmtimet me sa është e mundur, duke ju përmbajtur udhëzimeve të marra nga Kompania e Sigurimeve "Elsig";
- 2.3 T'i vihen në dispozicion Siguresit të gjitha të dhënat dhe provat e disponuara, të cilat i kërkojnë, e të cilat janë të duhura për ta caktuar përfshirjen dhe lartësinë e dëmit;
- 2.4 Të kontribuojë në përcaktimin e fakteve sa më shumë që të jetë e mundur, të dorëzohen të gjitha dokumentet në dispozicion dhe çelësat e automjetit, pas ndodhjes së vjedhjes para pagesës së dëmit;
- 2.5 Të marrë pëlqimin e siguresit para fillimit të riparimit ose asgjësimit të automjetit të dëmtuar dhe t'i japë atij mundësinë për të inspektuar automjetin e dëmtuar, për aq sa ai mund të pritë në mënyrë të arsyeshme;
- 2.6 Në rast të vjedhjes, lajmërimi apo denoncimi duhet të bëhet menjëherë pranë organeve kompetente;
- 2.7 Në rast të realizimit të rrezikut të vjedhjes nëse automjeti gjendet para skadimit të afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e paraqitjes së rastit njësitit kompetent policor, i siguruari është i detyruar ta pranojë automjetin.

Nëse automjeti gjendet pas skadimit të afatit 30 ditësh nga dita e paraqitjes së rastit njësitit kompetent policor dhe para se Kompania e Sigurimeve "Elsig" të paguajë dëmin, i Siguruari është i obliguar që ta pranojë automjetin. Kur automjeti gjendet pas skadimit të afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e paraqitjes së rastit te njësitit kompetent policor kur Kompania e Sigurimeve "Elsig" ia ka kompensuar siguresit dëmin, Kompania e Sigurimeve "Elsig" bëhet pronare e automjetit;

- 2.8 Shkelja e këtyre detyrimeve me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e siguresit ose të ndikojë në përcaktimin e rrethanave të tilla, të cilat janë qartësisht të rëndësishme për kryerjen e punës nga siguresi, nëse kjo shkelje për përcaktimin ose shkallën e detyrimit për të paguar siguresit ka pasur ndikim. Nëse këto detyrime janë shkelur qëllimisht ose në mënyrë të pafavorshme për arsye të tjera, dëmshpërblimi i siguresit do të jetë i vlefshëm vetëm për aq sa detyrimet për të përcaktuar ngjarjen e siguruar ose përcaktimin e detyrimit për të paguar dhe fushëveprimi i tyre janë të rëndësishme për siguresit dhe kjo është gjithashtu e qartë për mbajtësin e policës.

#### Neni 11

##### Pjesëmarrja e të siguruarit në dëm-franshiza

Një zbritje aplikohet për secilin automjet dhe për çdo ngjarje të siguruar me shumën e dakorduar në secilin rast dhe të specifikuar në policë:

1. Nëse te sigurimi Kasko i plotë është kontraktuar që i Siguruari vet do ta bartë një pjesë të dëmit (franshiza) zhvendëtimi do të zvogëlohet për shumën e kontraktuar te franshizës;
2. Franshiza mund të kontraktohet në shumë të hollash ose në përqindje të dëmit si dhe e kombinuar;
3. Kur franshiza e kontraktuar bëhet në shumë të hollash, të Siguarit dëmi i paguhet duke ja zbritur shumën e franshizës së kontraktuar;
4. Kur franshiza është e kontraktuar në përqindje të dëmit, dëmi paguhet duke ja zbritur përqindjen e kontraktuar.

##### Franshiza e detyrueshme për më shumë dëme

Për të siguruarin, i cili gjatë një viti të sigurimit ka dy apo më shumë dëme të paraqitura, llogaritet franshiza e detyrueshme për më shumë dëme. Franshiza llogaritet në atë mënyrë që të siguruarit i paguhet (kompensohet) dëmi i zbritur në përqindje nga dëmi i llogaritur, varësisht nga përsëritja e dëmit brenda një viti siguresi në vijim:

- Tek dëmi i dytë 10 %,
- Tek dëmi i tretë 20 %,
- Tek dëmi i katërt dhe çdo dëm tjetër i mëtejshëm 50 % në dëm.

Shuma e Franshizës së detyrueshme për më shumë dëme nuk mund të jetë më e vogël se 100 euro.

#### Neni 12

##### Dëmshpërblimi lartësia e dëmit

Siguresi dëmshpërblen apo kompenson të gjitha kërkesat duke i zbritur pjesën e zbritshme të rregulluar sipas policës apo kontratës së sigurimit, si në pikat më poshtë:

1. Kompensimi në rast dëmi apo humbjes totale;
- 1.1 Një dëm apo humbje e plotë do të konsiderohet, të ketë ndodhur si rezultat i një ngjarjeje të mbuluar nga sigurimi;
- 1.1.1 Kur automjeti është shkatërruar ose
- 1.1.2 Nuk është rikthyer brenda dy muajve nga marrja e kërkesës për vjedhjen e automjetit;
- 1.1.3 Shpenzimet e mundshme të riparimit (e rikthimit të automjetit në gjendjen para aksidentit) te automjetit të siguruar plus vlera e mbetur e tejkalon vlerën e automjetit sipas pikës 1.2.;
- 1.2 Siguresi paguan shumën që mbajtësi i policës do të kishte shpenzuar në një automjet të njëjtit lloj dhe cilësi në vlerën e njëjtë që kishte automjeti para se të ndodhte dëmi (vlera e zëvendësimit). Vlera e automjetit të dëmtuar duhet të zbritet nga vlera e zëvendësimit;
- 1.3 Tek dëmi total apo vjedhja e automjetit sipas vlerës së automjetit në tregun e Kosovës në momentin e ndodhjes së dëmit, e zvogëluar për vlerën e tregut të pjesës së mbetur të automjetit dhe sipas gjendjes së automjetit para dëmtimit.
2. Mbulimi i sigurimit për dëmtim të pjesëshëm;
- 2.1 Nëse nuk ka humbje totale (pika 1.1), siguresi
- 2.1.1 Mbulon shpenzimet e nevojshme të riparimit (rregullimit) dhe rikthimit të automjetit në gjendjen para aksidentit;



2.1.2 Shpenzimet e nevojshme të lëvizjes së automjetit në punëtorinë më të afërt, të aftë për të kryer siç duhet riparimin e automjetit. Këto shpenzime do të rimbursohen vetëm atëherë nëse janë kontraktuar në policën e sigurimit;

2.2 Për shpenzimet e pjesëve të zëvendësimit apo ndërrimit, dëmi do të zvogëlohet për pjesët e amortizuara varësisht nga gjendja e automjetit dhe vjetërsia e tij;

2.3 Lartësia e dëmit me marrëveshje mund të përcaktohet në bazë të faturave të paguara për riparim apo përmes arritjes së kompromisit në mes të siguruarit dhe K.S."Elsig" sh.a.;

2.4 Në rast të thyerjes së xhamit të përparmë, anësor, dritareve të pasme të automjetit, si pasojë e rënies së ndonjë pjese nga ndonjë kamion në lëvizje e duke u vërtetuar me dokumentacion zyrtar nga organet kompetente se mbajtja e distancës ka qenë në rregull atëherë siguroesi do të kompensoi të siguruarin;

4. Nëse automjeti është gjetur, shpenzimet aktuale të rikthimit do të rimbursohen deri në një maksimum prej 5% të vlerës së zëvendësimit pa zbritur ndonjë zbritje (Franshize);

5. Siguroesi paguan kompensimin për sigurimin e automjetit të përdorur në bazë të një "inspektimi të rastit" nga një person i autorizuar nga Siguroesi. Në rast të dëmeve të mëparshme kompensimi do të zvogëlohet me shpenzimet fiktive të riparimit të dëmeve. Një dëm konsiderohet i mbuluar nëse koha e ndodhjes së dëmit përkon me datën e fillimit të sigurimit (pra nëse dëmi ka ndodhur pasi që ka filluar periudha siguroese);

6. Kompania e Sigurimeve "Elsig" sh.a. mund të paguaj shpenzimet e riparimit të automjetit edhe drejtpërsëdrejti në llogarinë e Servisit, i cili e ka kryer riparimin, nëse ashtu dëshiron i siguroari dhe nëse Kompania e Sigurimit paraprakisht konfirmon pranimin dhe pagesën e atij dëmi në servisin e caktuar.

#### Neni 13

##### Afati për kompensimin e dëmit (pagesën e dëmshpërblimit

1. Kur ndodh ngjarja e siguarit, atëherë siguroesi duhet që dëmshpërblimin apo shumën e caktuar me kontratë ta paguaj brenda afatit kohor prej 15 ditësh, duke llogaritur kohën nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për kompensimin e dëmit.

2. Nëse nevojitet një kohë e caktuar për të vërtetuar obligimin e siguroesit për të dëmshpërblimit apo për të vërtetuar lartësinë atij dëmshpërblimi, atëherë afati për kompensim fillon të llogaritet nga dita kur ekzistimi i obligimit për dëmshpërblim, si dhe lartësia e tij janë përcaktuar.

3. Afati kohor për zhdëmtim sipas pikave 1 deri 2 vendnumëron, nëse me faj të kontraktuesit të sigurimit dëmi apo lartësia e tij nuk mund të përcaktohen, apo pagesa nuk mund të ekzekutohet.

4. Zhdëmtimi(pagesa e kompensimit për dëmin) nuk mund të kërkohet në asnjë mënyrë prej siguroesit, nëse

4.1. Ka dyshime, rreth së drejtës për të marrë pagesën e kompensimit të dëmit nga paraqitësi i kërkesës për zhdëmtim, dhe atë deri sa të sillen provat e nevojshme që nuk është ashtu;

4.2 Në rast se si pasojë e dëmit të shkaktuar, janë nisur hetime ndaj kontraktuesit të sigurimit apo paraqitësit të kërkesës për zhdëmtim dhe atë nga policia, institucionet(autoritetet) zyrtare, apo për çështje penale nga ndonjë gjyq, siguroesi mund të shtyj afatin e pagesës deri në përfundimin e hetimeve.

#### Neni 14

##### Regresi

Kur siguroesi, i kompensoi dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguroesi.

#### Neni 15

##### Ekspertiza

Ekspertiza duhet të behet nëse ndonjëra pale kontraktuale, paraqet kërkesën për një gjë të tillë. Nga kjo procedure mund të nxirren vetëm konkludime rreth shkakut dhe lartësisë së dëmit.

1. Shpenzimet e ekspertizës, i ndajnë palët në kontratë solidarisht.

2. Siguroesi dhe kontraktuesi i sigurimit mund të merren vesh, që të kërkojnë të behet një ekspertizë e jashtme me konkluzionet obliguese për të dy palët. Te njëjtën ta krye një ekspert i vetëm, i cili do të zgjidhet nga të dy palët.

#### Neni 16

##### Situata ligjore pas dëmit

Pasi të ketë ndodhur dëmi, si siguroesi ashtu edhe kontraktuesi i sigurimit kanë të drejtë të shkëpusin kontratën e sigurimit, me kusht që kufiri minimal të jetë tejkaluar. Llogaritjet që ky kufi minimal është tejkaluar nëse dëmet e shkaktuara

në periudhën aktuale të sigurimit, janë më të larta se 1 përqindje e shumës së përgjithshme të sigurimit (0,01 \* Shuma e sigurimit).

Siguroesi duhet t'i përmbahet një afati kohor prej një muaji në rast se e shkëput kontratën – me fjalë të tjera kontrata mbetet në fuqi edhe për një muaj nga momenti i shkëputjes së saj. Kontraktuesi i sigurimit nuk mund të shkëpusë kontratën më vonë se fundi i periudhës aktuale të sigurimit.

Nëse klienti ka tentuar të marrë kompensim nga siguroesi përmes mashtrimit, atëherë siguroesi ka të drejtë që sapo të ketë refuzuar të bëjë kompensimin, menjëherë të shkëpusë kontratën dhe atë pa afat pritje(kontrata nuk mbetet në fuqi për asnjë moment pas shkëputjes).

Ne rast të dëmit total apo vjedhjes së automjetit Sigurimi Kasko përfundon dhe atë ne datën e ndodhjes së dëmit total apo vjedhjes së automjetit.

Siguroesi ka të drejtën e shpërblimit për periudhën e kontratës deri në përfundimin e kontratës.

#### Neni 17

##### E drejta për ankesë

- Nëse i siguroari gjykon se siguroesi nuk i përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit, ai mund të paraqesë një ankesë pranë siguroesit.
- Siguroesi i përgjigjet çdo ankesë të dorëzuar me shkrim apo në formë elektronike nga i siguroari apo persona të tjerë të interesuar dhe jep çdo informacion të kërkuar, që ka lidhje me kontratën e sigurimit.
- Ankesat e të siguruarve trajtohen në mënyrë të paanshme dhe brenda afatit të përcaktuar me akte nënligjore.
- I siguroari ka të drejtë t'i drejtohet BQK-së për çdo pakënaqësi të trajtimit të ankesës së tij nga siguroesi apo vlerësuesve të dëmeve apo profesionisteve tjerë të sigurimeve.

#### Neni 18

##### Shkëputja e kontratës së sigurimit dhe kthimi i premisë së sigurimit

Kontrata e sigurimit munde të shkëputet apo të ndërpritet pas njoftimit me shkrim të secilës pale që e dëshiron këtë duke përcaktuar datën e shkëputjes së saj.

1. Siguroesi do të shkëput apo ndërpritet kontrata e sigurimit në qoftë se :

- Nuk është paguar primi i sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e ripërtëritura. Data e shkëputjes do të jete 15 dite pas mbarimit të afatit për pagese
- Duke njoftuar 30 dite përpara datën e shkëputjes
- Kur të siguruarit i është marre patentë shoferi gjate muajve të fundit
- Me pagimin apo kompensimin e dëmeve, më realizimin e rrezikut të vjedhjes së automjetit,
- Me pagimin apo kompensimin të dëmit në lartësinë e shumës së kontraktuar të sigurimit për një rast dëmi
- Me përmbushjen e lartësisë së shumës së sigurimit të shënuar në police të sigurimit për disa raste të sigurimit në periudhën e njëjte të sigurimit(shuma e të gjitha dëmeve deri në shumën e sigurimit)
- Kur riparimi i automjetit ekonomikisht nuk është i arsyeshëm (dëmi total ekonomik) shitjen e automjetit,

Në qoftë se Siguroesi i ofron të Siguarit ose personit të autorizuar ripërtëritjen e kontratës dhe këta të fundit nuk e pranojnë, kontrata do të përfundojë automatikisht në fund të periudhës së sigurimit.

1. Primi i sigurimit kthehet atëherë kur;

Kur i siguroari e ka ç 'lajmëruar automjetin për shkak të asgjësimit, daljes jashtë përdorimit, humbjes së automjetit atëherë Kompania e Sigurimeve Elsig sha është e obliguar, që me kërkesën e të Siguarit ta kthejë pjesën e pashfrytëzuar të premisë, nëse deri në ditën e ç 'lajmëruar nuk e ka realizuar dem për rastin e siguruar.

Ne raste se deri në momentin e ç 'lajmëruar të automjetit (për shkak të asgjësimit, daljes jashtë përdorimit apo humbjes së automjetit) ka realizuar rastin e siguruar, kontraktuesi nuk ka të drejtë të kthim të premisë dhe është i obliguar të paguaj gjithsej shumën e premisë për periudhën e kontraktuar.

Ne rast të ndërrimit të pronarit të automjetit Kompania e Sigurimeve Elsig sha është e obliguar me kërkesën e Kontraktuesit të ja kthejë pjesën e premisë së pa shfrytëzuar, nëse deri në atë date nuk është bere dem për rastin e siguruar.

Kalkulimi i kthimit të premisë realizohet sipas metodës së "pro rata temporal" d.m.th. nga dita e paraqitjes së kërkesës për ndërrim pronari. Kthehet premia e pa shfrytëzuar.

Premia nuk kthehet nëse kompania e sigurimeve Elsig regresohet nga personi përgjegjës për dëmin.

Kthimi i primit kur shkëputja ndodh nga Siguruesi apo i Siguruari do te jete proporcionale me pjesën e mbetur te periudhës se sigurimit pasi te jen zbritur shpenzimet administrative ne masën prej 10% te primit te shkruar bruto.

#### **Neni 19**

##### **Forma e shkruar**

1. Të gjitha marrëveshjet, paraqitjet, kërkesat dhe sqarimet rreth kontratës së sigurimit, duhet të bëhen me shkrim. Sqarimet e siguruesit janë të vlefshme vetëm nëse janë në formë të shkruar dhe përmbajnë: emrin zyrtar të kompanisë, adresën e saktë të kompanisë nënshkrimin e personit të autorizuar për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale për kompaninë dhe vulën e kompanisë. Letrat e kontraktuesit të sigurimit dhe të siguruarit janë ligjërisht të vlefshme vetëm nga momenti kur arrijnë në selinë qendrore të siguruesit.

2. Siguruesi pasi që të ketë marrë kërkesën për sigurim, mund të kërkojë informacione shtesë dhe sqarime të tjera. Në këtë rast llogaritet që kërkesa për sigurim i ka arritur siguruesit vetëm atëherë kur siguruesi pranon të gjitha informacionet shtesë dhe sqarimet e kërkuara.

3. Nëse ende nuk ka ndodhur ngjarja e siguruar, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë që brenda afatit kohor prej 10 ditë pune nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sigurimit (apo nga momenti i ardhjes së policës me postë apo në ndonjë mënyrë tjetër), të shkëpusë kontratën e sigurimit duke i dërguar me shkrim siguruesit njoftimin për shkëputjen e kontratës.. Me këtë rast kontraktuesit të sigurimit i kthehet primi i parapaguar mirëpo pa pjesën e mbajtur nga siguruesi për shkak të shpenzimeve administrative, lartësia e së cilës është 10% e primit të parapaguar.

#### **Neni 20**

##### **Marrëveshja për qivqin përgjegjës**

1. Mospajtimet mes siguruesit në njërin anë, dhe kontraktuesit të sigurimit bashkë me të siguruarit në anën tjetër, zgjidhen njëzëri, në pajtim me rregullat interne të siguruesit.

2. Në rast se, marrëveshja njëzëri nuk është e mundur, atëherë kontraktuesi i sigurimit në pajtim me ligjin për sigurimet ka të drejtë ti drejtohet me ankesë forumit të pavarur të arbitrazhit.

3. Në rast se, kontraktuesi i sigurimit nuk është i kënaqur me vendimin e forumit të pavarur të arbitrazhit atëherë ai ka të drejtë që në pajtim me rregulloret në fuqi t'i drejtohet gjyqit përkatës me kërkesën për anulimin e vendimit të atij forumi.

#### **Neni 21**

##### **Sigurimi Kasko për automjetet e dhëna me qira (LEASING)**

1.Sigurimi i automjeteve te dhëna me qira afatgjate (Leasing) te drejtat nga kontrata e sigurimit i takojnë qiradhënësit (Pronarit te automjetit) i cili në policë përcaktohet si i Siguruari.

2.Ne rastet kur marrësi i Leasing i cili ne te njëjtën kohë është edhe Kontraktuesi, e blenë automjetin para skadimit të policës së sigurimit të drejtat dhe detyrimet nga kontraktuesi i sigurimit kalojnë tek marrësi i Leasingut që nga momenti i bartjes së pronësisë dhe kontrata mbetet në fuqi.

3.Marrësi i Leasingut detyrohet që menjëherë pas blerjes së automjetit ta njoftoje Kompanin e Sigurimeve "Elsig" mbi shitblerjen dhe të dokumentoj bartjen e pronësisë.

#### **Neni 22**

##### **Ndryshimi i kushteve të sigurimit apo i tarifës së primit**

1. Nëse siguruesi ka ndryshuar kushtet e sigurimit apo tarifën e primit, atëherë ai duhet që për këtë ndryshim të lajmërojë kontraktuesin e sigurimit të paktën 60 ditë para përfundimit të vitit aktual të sigurimit.

2. Kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë që, brenda 60 ditëve pas marrjes së njoftimit ta shkëpusë kontratën, me çka kontrata pas përfundimit të vitit aktual të sigurimit bëhet e pavlefshme.

3. Në rast se kontraktuesi i sigurimit nuk e shkëputë kontratën, atëherë me fillimin e vitit të ardhshëm (vitit pasues) të sigurimit, për këtë kontratë janë të vlefshme kushtet e reja të sigurimit dhe tarifa e re e primit.